


GAZETA JAVORE

Barazi
Toleranca Komuniteti
Të drejtat
e njeriut Ligji Liri
Edukimi Populli Demokraci
Debat Drejtësi Mbrojtje
Etnia Puna Integriteti
Kultura Pavarësia
zhvillim Solidaritet




DEMOKRACIA

DEMOS-KRATIA

RIOLT (10), VALDRIN (11), DION (10), ELSA (9), HANA (10), FJOLLA (10), ALEJNA (10), ENSAR (10),

ANDI (10)



Qeverisja e mirë e ka vetëm një emër: demokraci

Demokracia është forma më e mirë e qeverisjes së një shteti.

Kjo rrjedh nga greqishtja e lashtë, ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ do të thotë udhëheqje. Pra, demokracia është udhëheqje e popullit.



Populli i zgjedh deputetët dhe pastaj ata miratojnë ligjet. Ligje këto të cilat e përmirësojnë jetën në shtet. Disa nga elementet e demokracisë janë: të drejtat e njeriut (të siguruar me ligj), toleranca, solidariteti, drejtësia, barazia, etj. Në demokraci të gjithë duhet të kemi të drejta të barabarta. Gjithashtu, në demokraci nga ne si qytetarë kërkohet që të mendojmë dhe veprojmë së bashku, si dhe t'i gjindemi njëri-tjetrit kur kemi nevojë për ndihmë.

Demokracia na bën të ndihemi vërtetë një popull i fortë

me ligje dhe rregulla. Shteti ynë demokratik investon në gjeneratat e reja në mënyrë që ato të përgatiten sa ma mirë për sfidat e jetës. Po ashtu, në mënyrë që secili prej nesh të ketë një profesion me të cilin ne i ndihmojmë shtetit të zhvillohet.

Ne si shtet kemi shumë njerëz të cilët janë të suksesshëm. Marrim shembull Majlinda Kelmendi e cila është kampione bote në xhudo. Edhe pse është sportiste ajo i ka ndihmuar shumë shtetit tonë. Njerzit e tillë të suksesshëm na bëjnë të ndihemi krenarë.

Neve na mbetet të punojmë shumë si Majlinda Kelmendi dhe secili në mënyrën e vet të ndikojë në mirëqenien e popullit dhe vendin tonë demokratik.

Ne jemi krenarë që jemi pjesë e një vendi demokratik sikur është Republika e Kosovës.



Gazetarët e rinjë

PUSHTETI EKZEKUTIV - QEVERIA

EBUBEKËR (10), AMELA (10) HANETA (10), DREN (10), DIELLZA (9), ERJON (10), MEDINA (10),
ALBERT (10), AMAR (10)

Për atë se çfarë institucioni është Qeveria dhe se kush punon aty, lexojeni më poshtë artikullin tonë

Kosova është një shtet demokratik, në të cilin ne si qytetarë kemi shumë të drejta.

Ky shtet ka shumë institucione të rëndësishme, të cilat na lehtësojnë jetën tonë. Kuvendi është institucion në të cilin punojnë përfaqësuesit tanë të cilët janë deputetët e zgjedhur nga vetë ne. Deputetët janë ata të cilët e zgjedhin Kryeministrin e shtetit, i cili është udhëheqës i një institucioni tjetër të rëndësishëm, e që është Qeveria.

Qeveria është Pushtet Ekzekutiv, që do të thotë se propozon projektligje në Kuvendin e Kosovës.

Me t'u miratuar ato ligje, Qeveria i vë në funksion ato dhe i zbaton bashkë me qytetarët.

Pjesë e Qeverisë janë edhe zëvendëskryeministrat dhe ministrat, të cilët bashkë me Kryeministrin e mbajnë përgjegjësinë për vendimet të cilat merren në këtë institucion. Ministrat kryejnë punë të ndryshme. Për shembull, Ministri i Arsimit merret me çdo gjë që ka të bëjë me arsimin. Ministri i Shëndetësisë merret me çështjet shëndetësore, e kështu me radhë.

Në shkollën tonë kemi nevoja të ndryshme. Kemi nevojë për rregullimin e dërrasave të zeza, bankave, etj. Këtu do të mund të na ndihmonte Ministria e Arsimit dhe t'i rregullonte këto. Ne gjithashtu kemi shumë gjëra pozitive si kemi mjekun e shkollës, i cili kujdeset për shëndetin tonë, e që do ishte mirë që të gjitha shkollat e Kosovës të kishin nga një mjek.

Urojmë që Kosova të miratojë ligje që do ta përmirësonin Kosovën në të gjitha fushat.



Me anë të votave të deputetëve, zgjedhet Kryeministri



Kryeministri është personi i cili e udhëheqë Qeverinë




Gazetarët e demokracisë



Projektligji i propozuar nga Qeveria

TË DREJTAT E FËMIJËVE

ERINA (10), ED (10), SUAD (9), ERBLINA (10), ARITA (10), SHKURTA (10), YLL (10), ERZA (10), DION (10)



Më poshtë është një artikull i këndshëm i shkruar nga grupi ynë

Përshendetje lexues i dashur. Emri im është „fëmijë“. Në këtë artikull unë jam duke shkruar në emër të të gjithë fëmijëve të botës.


Ne si fëmijë kemi shumë nevojë për të gjithë ju të rriturit. Kemi nevojë të na duani, të na respektoni dhe të udhëheqni drejt suksesit. Mirëpo, gjëja më e rëndësishme për të cilën kemi nevojë është të na i respektoni të drejtat.

Po pra, ne kemi shumë të drejta. Për ne, e drejtë do të thotë liri. Prandaj, ne duam që të respektohen të drejtat tona. Sigurisht se të drejtat tona mbrohen me ligj. Ne madje kemi një dokument të veçantë që i mbron ato. Ky dokument quhet: Konventa e të Drejtave të Fëmijëve dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1990.

Disa nga të drejtat e mia janë: të luaj, të shkollohem, të veshëmbathem, të kem familje, të shpreh mendimin, etj. Të gjithë ne fëmijët jemi të barabartë, pavarësisht fesë, racës dhe kombit.

Fëmijë të dashur, unë kam një porosi për ju. Mos harroni që të respektoni të drejtat e njëri-tjetrit. Aq sa kemi nevojë që të rriturit të respektojnë të drejtat tona, po aq kemi nevojë që edhe ne t'i respektojmë të drejtat e gjithë fëmijëve kudo në botë.

Le të jetë dashuria që ne falim, një kopsht i bukur me lule. Po aq i bukur sa edhe demokracia në jetën e gjithë qytetarëve të saj.



Këtu janë paraqitur disa nga të drejtat tona të cilat i gëzojnë të gjithë fëmijët



Grupi i cili ka shkruar këtë artikull me shumë dashuri dhe përkushtim

KUVENDI MË PËRFAQËSON MUA

ERIS (11), FLANDRA (10), ILIRIDA (10), ALTINA (10), ALTINA I. (10), RINOR (10), AURON (10), YLLI (10)

ARLIND (10)



A dëshironi të dini se si Kuvendi ju përfaqëson juve? A dëshironi të dini pse Kuvendi është Institucioni më i rëndësishëm demokratik? Nëse po, lexojeni me vëmendje artikullin tonë

Ne sot patëm rastin të mësojmë për Kuvendin, kurse juve ju ftojmë edhe juve që të informoheni sa më shumë për të, se me të vërtetë ia vlen.

Kuvendi më përfaqëson mua, sepse unë në shtetin tim demokratik kam të drejtën të zgjedh. E drejta për të zgjedhur më jep vlerë dhe fuqi. Këtë të drejtë e ka secili qytetar i Kosovës mbi moshën 18 vjeçare, dhe përmes saj qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e popullit të cilët janë deputetët. Përfaqësuesit i paraqesin në Kuvend kërkesat dhe interesat tona. Pikërisht, për këtë arsye Kuvendi ka vlerë dhe rëndësi të madhe.

Kuvendi ka menduar për të ardhmen tonë, duke na dhënë kështu mundësinë që të gjithë të kemi shkollimin fillor të obligueshëm. Por, Kuvendi ka miratu-



ar edhe ligje të tjera që e lehtësojnë jetën tonë. Për shembull: ligjet për shëndetësinë, ekonominë, infrastrukturën, të drejtat e njeriut, etj. E meqenëse Kuvendi kujdeset për të ardhmen tonë, edhe ne duhet të jemi të kujdesshëm ndaj tij. Kjo nënkupton se nga ne kërkohet që t'i respektojmë dhe zbatojmë ligjet e marrura në Kuvend. Po ashtu, ne duhet të jemi qytetarë aktiv duke e ndihmuar vendin tonë dhe duke u kujdesur për ambientin.



Unë flasë në emër të popullit tim



Ne jemi autorët e këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hilmi Rakovica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë

Kjo kopje nuk është e redaktuar nga Kuvendi i Kosovës